

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtarja **Ilijana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit D.Q., nga Gj., për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275/2 lidhur me par.1 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë, PP.nr.632/18 të datës 30.05.2018, në shqyrtimin fillestar, të mbajtur më datë **12.11.2018**, në prani të Prokurorit të shtetit Ismet Tofaj si dhe të akuzuarit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

## A K T G J Y K I M

I akuzuari **D.Q.**, nga Gj., Rr."A.Rr." nr..., data e lindjes..., ne Gj., i biri i F. dhe i nënës V. e gjinisë H., ka të kryer shkollën e mesme, kamarier, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i pa martuar, me ID. ....

### Ë s h t ë f a j t o r

**Sepse :**

**-me dt. 24.04.2018, rreth orës 15.00 min**, në Gj., në Rr "M.C.", deri sa ishte duke drejtuar motoçikletën është ndaluar nga policia, në kundërshtim me nenin 9 e 14 të ligjit për barnat narkotike, e duke e ditur se ka të bëjë me substancë narkotike e duke mos e poseduar leje nga organi kompetent, në xhepin e vogël të pantallonave i është gjetur në posedim pa autorizim narkotiku dhe atë një qese najloni me substancë bimore me ngjyrë të gjelbër e cila pas ekzaminimit të A. P., ka rezultuar të jetë narkotikë llojit Kanabis (Marihuanë), në peshë neto prej 2.20gr +-0.0001gr, e substanca është sekuestruar, e gjendet në stacionin policor në Gjakovë.

**-me çka ka kryer veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275/2 të KPRK-ës,**

Andaj Gjykata në bazë të nenit 4,17,41, 49,50,51,73, neni 275/2 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP, të akuzuarit i shqipton :

### DENIM ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1(një) viti**, nuk kryen veprë tjetër penale.

Detyrohet i akuzuari që të paguajnë shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor shumë prej **30,00.-€**, në afat prej **15** ditësh, e krejt këtë pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

**Mbikëqyrjen e periudhës verifikuese të dënimit me kusht do ta bene Shërbimi Sprovues i Kosovës Dega në Gjakovë .**

Gjykata bazuar në nenin 275 par.3 të KPRK-ës lidhur me nenin 62 par.2 pika 2.7, të akuzuarit ia shqipton masën e :

## MARRJA E SENDEVE

Konfiskohet substanca narkotike e llojit Kanabis ngjyrë e gjelbër e dyshuar te jetë substancë narkotike e llojit "Marihuan" me peshë 2.20gr +-0.0001gr., që është objekt i kësaj vepre penale e sekuestruar me dt. 24.04.2018.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.632/18 të datës 25.05.2018, ka akuzuar të akuzuarin D.Q., nga Gj., për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275/2 të KPRK-ës, duke propozuar që i njëjti të shpallet fajtor te dënohet sipas ligjit dhe te obligohet ne pagesën e shpenzimeve procedurale si dhe konform neni 275 par.3 ë KPRK-ës ,të përcaktohet dënimi plotësues që substanca e sekuestruar narkotike e sekuestruar të konfiskohet përherë dhe të bëhet asgjësimi i saj.

Gjatë shqyrtimit fillestar gjyqësor të mbajtur me dt.12.11.2018, prokurori i shtetit Ismet Tofaj, bene leximin e aktakuzës PP.nr.632/18, të dt.25.05.2018 dhe deklaroi se mbetet ne tërësi pranë aktakuzës por në rreshtin e 6-të pas marrjes së raportit të ekspertimit nga A. K. e F. sa i përket peshës ku është shkruar 2gr, bëhet 2.20gr +-0.0001gr., e po ashtu për shkak të gabimit të natyrës teknike duhet të hiqet fjala bashkëkryerje neni 31 të KPRK-së.

I akuzuari D.Q., gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se jam penduar për veprën e kryer ,pretojë se një veprim i tillë nuk do te përsëritet , andaj i propozoi gjykatës qe te marr parasysht rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë , pendimin e shprehur ne gjykate ,si dhe faktin se është hera e pare qe kam ra ne ndesh me ligjin te me shqiptojë një dënim me te butë.

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit Prokurori i shtetit Ismet Tofaj, deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi qe i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favoret juridike te pranimi te fajësisë ,dhe se aktakuza ka mbështetje ne provat materiale qe gjenden ne shkresat e lendes.

Ne shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari D.Q.: me dt. 24.04.2018, rreth orës 15.00 min, në Gj., në Rr "M. C.", deri sa ishte duke drejtuar motoçikletën është ndaluar nga policia, në kundërshtim me nenin 9 e 14 të ligjit për barnat narkotike, e duke e ditur se ka të bëj me substancë narkotike e duke mos e poseduar leje nga organi kompetent, në xhepin e vogël të pantallonave i është gjetur në posedim pa autorizim narkotiku dhe atë një qese najloni me substancë bimore me ngjyrë të gjelbër e cila pas ekzaminimit të A.P. , ka rezultuar të jetë narkotikë llojit Kanabis (Marihuanë), në peshë neto prej 2.20gr +-0.0001gr, e substanca është sekuestruar, e gjendet në stacionin policor në Gj..

Pasi gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë për veprën penale që i vihet në barrë dhe është bindur se pranimin e ka bërë në baza vullnetare, duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban propozim akuza ,ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 326 par.4 te KPP, dhe shqyrtimin gjyqësor e ka përfunduar pa administrimin e provave.

Me rastin e matjes së dënimit ,gjykata ka pasur parasysht të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit .Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa

si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, sjelljen korrekte të akuzuarit në gjykim, gjendjen e dobët ekonomike të akuzuarit, pendimin e tij, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale si dhe faktin se është hera e parë që ka rënë në ndesh me ligjin, të cilat rrethana ndikuan që Gjkata ti zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 73 të KPRK-së, Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht duke ia vërtetuar dënim me burgim në kohëzgjatja prej 6 (**gjashtë**) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1 (**një**) viti, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për konfiskimin e substancës narkotike të llojit kanabis (marihuanë), me peshë prej 2.20gr +-0.0001gr, që është objekt i kësaj vepre penale e sekuestruar me dt. 19.01.2018, u murr komform nenit 275 par.3 të KPRK-ës lidhur me nenin 62 par.2 pika 2.7 nenit 69 të KPRK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P. nr.390/18 më datë 12.11.2018**

**Sekretarja juridike,  
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,  
Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.